

Akademik Ali Hadri

PUSHTETI USHTARAK NË KOSOVË MË 1945

Vendosja dhe funksionimi i pushtetit ushtarak në Kosovë në shkurt 1945 është një problem me interes shkencor për historiografinë tonë. Kjo gjë më ka shtyer, duke studiuar historinë e Lëvizjes Nacionalçlirimtare të Kosovës, që pak a shumë të merrem edhe me këtë problem, të arrijë gjer ke disa mendime që zbatohen në të dhënat e pakta, të cilat i kemi në disponim, dhe pastaj t'i them disa fjalë edhe me shkrim — të botuara në librin »LNC në Kosovë më 1941—1945«, por duke bërë një kufizim, duke thënë se ky është problem i veçantë, që kërkon studim shumë më të thellë, më të gjerë, të mbështetur në materialin burimor dhe memorial.

Po këtë gjë po e theksoj dhe po e nënvizoj edhe sot. Meqë problemi në fjalë është mjaft i ndërlikuar dhe me interes shkencor, kërkimet tona shkencore duhet të bëhen në këto drejtime: të grumbullohet sa është e mundur, gjer në maksimum, materiali arkivor dhe ai të sistemohet si duhet; të grumbullohet sa është e mundur, gjer në maksimum, materiali memorial — kujtimet e bashkëkohanikëve, e sidomos nga ata që qenë në burim të ngjarjeve, dhe ky material të sistemohet. Pasi të kryhen të gjitha këto punë, t'i hymë edhe hartimit të një punimi me karakter shkencor, lidhur me këtë problem, kuptohet shikuar nga aspekti historik-marksist.

Unë po shtroj vetëm disa teza lidhur me këtë temë, të cilat kanë për qëllim t'u ndihmojnë atyre, që do të merren me historinë e pushtetit ushtarak në Kosovë, në kërkimet dhe në trajtimin shkencor të këtij problemi.

Së pari, shtrohet pyetja: ku janë vendosur, pushtetet ushtarake në Jugosllavi? Kjo gjë dihet — në një pjesë të Vojvodinës, në zonën e Triestës dhe këtu në Kosovë. Lidhur me këtë, shtrohet edhe kjo pyetje: pse u vendosen pikërisht në këto vise, duke i shikuar çështjet me një metodë krahasuese? Meqë për pushtetin ushtarak në Vojvodinë kemi punime dhe materiale të botuara, nuk është vështirë të bëhen krahasimet, kuptohet pasi edhe ne ta kryejmë punën tonë në drejtim të grumbullimit të materialeve relevante.

Së dyti, në çfarë kohe u vendos pushteti ushtarak në Kosovë? Është periudha që nga 8 shkurti 1944 gjer në midisin e vitit 1945. Për shkencën, lidhur me këtë problem, është me interes të veçantë të studiohet raporti në mes të forcave të revolucionit, të forcave revolucionare dhe kundër-revolucionare në atë kohë në këtë anë. Në Kosovë kishte revolucion dhe kundër-revolucion që nga fillimi i Luftës Nacionalçlirimtare si dhe në çdo

anë të Jugosllavisë. Gjatë LNC u vendos pushteti revolucionar. Për ne është me interes të bëhet fjalë për forcat revolucionare dhe kundërrevolucionare në këtë anë gjatë tërë Luftës së Dytë Botërore, por me theks të veçantë në fund të 1944 dhe në fillim të vjetit 1945. Edhe këtu në simpozium u tha se në thelb forcat kundërrevolucionare ishin asgjësuar gjer me vendosjen e pushtetit ushtarak, do të thotë gjer në fillim të shkurtit 1945. Pushteti ushtarak bëri punën e vet, mbeturinat e forcave kundërrevolucionare u asgjësuan plotësisht. Në lidhje me kohën e vendosjes të pushtetit ushtarak, është me interes shkencor të shqyrtohet edhe çështja: çfarë gjendje zotëronte në Kosovë në krahasim me gjendjen në viset tjera të Jugosllavisë, jo vetëm aty ku janë vendosur pushtetet ushtarake, por edhe në viset tjera të vendit, ku gjithashtu kundërrevolucioni ishte i fuqishëm, çoftë kur është fjala për Lëvizjen ushtarake në Kroaci, çoftë kur është fjala për Lëvizjen çetnike në Serbi, etj.

Së treti, me interes shkencor do të ishte të bëjmë kërkime dhe të japim përgjigje shkencore edhe për arsyet e vendosjes të pushtetit ushtarak në Kosovë: cilat arsye janë vënë në dukje atëherë kur u vendos pushteti ushtarak? Kush i vuri në dukje? Kush e bëri kërkesën për vendosjen e pushtetit ushtarak në Kosovë? Si e arësyetoi atë kërkesë. Duke shikuar në pikëpamje shkencore rrethanat konkrete historike dhe duke i lidhur me arsyet që janë vënë në dukje në kohën kur u vendos pushteti ushtarak, të nxjerrim përfundime historike shkencore, gjë kjo që është domosdo kur dihet se ekzistojnë mendime të ndryshme lidhur me vendosjen e pushtetit ushtarak në Kosovë nga vetë organizatorët dhe udhëheqësit e LNC-së në atë kohë, gjë që shihet edhe nga shënimet stenografike mbi pushtetin ushtarak.

Së katërti, çfarë ishte përmbajtja e pushtetit ushtarak? Çfarë ishte struktura e tij në pikëpamje nacionale dhe regjionale? Pse trupi i pushtetit ushtarak përbahej nga njerëzit që nuk ishin nga Kosova? Cila ishte arsyeja që të bëhet një zgjedhje e tillë e trupit të pushtetit ushtarak? Lidhur me vendosjen e pushtetit ushtarak, u bënë ndryshime edhe në Shtabin Operativ të UNÇ dhe të Aradhave Partizane të Kosovës e Metohisë. Pse ndryshoi përbërja e Shtabit që ekzistonte para vendosjes të pushtetit ushtarak, i cili udhëhoqi me sukses luftën përfundimisht me çlirimin e Kosovës? Shtabi operativ i Kosovës kishte në atë kohë tetë vetë, prej të cilëve tre ishin nga Kosova, e prej tyre vetëm një shqiptar. Pes u veprua kështu?

Së pesti, do të ishte me interes shkencor që ata që merren me artin ushtarak, të na ndihmojnë në shqyrtimin e problemit se çfarë do të thotë në teorinë ushtarake pushteti ushtarak, rrjedhimisht në çfarë kategorie bën pjesë pushteti ushtarak në Kosovë.

Së gjashti, është me interes shkencor të trajtohet edhe problemi: Si është pranuar nga masat popullore pushteti ushtarak? Çfarë u arrit me atë? Çfarë gabimesh dhe të metash ka pasur në punën e vet pushteti ushtarak dhe pasojat e tyre?

Së shtati, do të ishte me interes shkencor të mbahen tubime shkencore lidhur me këtë problem, por pasi të bëhen përgaditjet me themel, në përputhje me atë që u tha më lart.

Kështu duhet vepruar me qëllim që me punë kolektive, të historianëve dhe të organizatorëve dhe luftarëve të dalluar të LNC-së, të zgjidhet problemi në fjalë. Po që se zgjidhjes shkencore të vendosjes të pushtetit ushtarak në Kosovë do t'i çasemi me qëllime të mira, aq më parë se është

fjala për një pjesë të pandarë të revolucionit tonë, por duke u mbështetur dhe në faktin se nuk ka dhe nuk mund të ketë tabu tema, jam i bindur se historiografia jonë edhe kësaj detyre të rëndësishme do t'i dalë në krye faqebardhë.

Académicien Ali Hadri

LE POUVOIR MILITAIRE EN KOSOVA

R é s u m é

L'établissement et le fonctionnement du pouvoir militaire en Kossova présente une question d'intérêt scientifique.

Si nous abordons ce problème objectivement, comme partie prenante de notre révolution, grâce aux documents historiques, nous pourrons y apporter une précieuse contribution à notre science.

